



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



0101/ Nr. 4245/2018
Data: 22.04.2018

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katërt - IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 19.04.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtore për Buxhet dhe Financa), Fari Kalisi (Drejtore për Administratë), Zaim Bela (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlasi (Drejtore për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Refet Kalisi (Drejtore për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Nexhmedin Daci (Drejtore për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Bajrush Laç (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Faruk Dermaku (Përfaqësues i OSB-së), Abil Thaçi (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL “Pastrimi”), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit), dhe qytetarë të ndryshëm të komunës së Hani të Elezit. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit financiarë për periudhën Janar-Mars 2018.
3. Informatë mbi ndarjen e bursave.
4. Informatë për raportin financiarë për periudhën Janar-Mars 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Informatë për raportin e performancës së komunës për vitin 2017.
6. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës keni edhe një material shtesë të cilin e kam dërguar, miratimin e listës së kandidatëve për komitete konsultative. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Nuriman Kuka thekson:- materialet shtesë të cilat dërgohen mendoj që duhet me u përcjell me kohë në mënyrë që me pas kohë për me shtjelluar materialin. Në të ardhmen duhet me pas kujdes në këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- sa i përket materialit shtesë mund të kërkonte që për me ua dërguar me kohë, kurse për pikat e rendit të punës kemi të drejtë aty për aty me shtuar pikë të rendit të punës sepse e parasheh ligji për Vetë Qeverisje Lokale dhe statuti i komunës.

Nuriman Kuka thekson:- nuk e pata fjalën që ju nuk keni të drejtë aty për aty me propozuar pikë të rendit të punës por ne si këshilltarë me pas materialin brenda pesë apo shtatë dite.

Mehmet Ballazhi thekson:- të drejtë nuk keni me shtijë në rend të ditës po mundesh me propozuar sepse është e përcaktuar që anëtarët e kuvendit e votojnë për me hyjë në rend të ditës. Kërkoj sqarim për komitete konsultative që i përmende më herët. Për materialin pajtohem me para folësin sepse sot po e marrim dhe duhet kohë për me shfletuar dhe kërkoj që për mbledhje të tjera të najë dërgoni me kohë. Pse është thirr seanca e kuvendit me këtë datë sepse po më duket që është pak e ngutshme dhe më duket kohë pak jo e përshtatshme për me i diskutuar çështjet apo ndoshta keni paraparë që nuk ka me pas diskutime.

Kryesuesi thekson:- si kryesuesi i kuvendit në bashkëpunim me ekzekutivin e propozoj një pikë të rendit të punës por çdo anëtarë i kuvendit të komunës ka të drejtë me propozuar pikë të rendit të punës, mirëpo kuvendi duhet ta miraton. Sa i përket caktimit të mbledhjes kam potencuar që mungesën e anëtarëve të kuvendit të komunës nuk mundem me arsyetuar, po në qoftë se ka kërkesa për ditë të caktuara që dikush do të mungon mundohem me ja përshtatur në mënyrë që mos me munguar ai anëtarë i kuvendit. Kërkesa ka pas për shkak të erskuzionit të shkollës së mesme dhe për atë një javë më herët e kam caktuar seancën e kuvendit.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk po e kontestojë që ka ndonjë problem por më duket periudhë shumë e gjatë sepse deri në muajin e ardhshëm i bien një periudhë një muaj e gjysmë që do të thotë se është një periudhë pak më e gjatë për me i diskutuar problemet. Duhet të jetë një periudhë e përafërt e caktimit të mbledhje në mënyrë që mos të jetë një muaj e gjysmë.

Mefail Suma thekson:- isha para dy apo tri dite i sëmurë dhe me ndihmë të shpejtë të ambulantes më kanë transferuar. Së pari falënderoj ekipin mjekësorë që ka qenë aty të cilët ma kanë dhënë ndihmën e parë, infermierja znj.Teuta Shkreta dhe kardiologun në spitalin e Ferizajt dr.Isa Berisha për ndihmën e dhënë. Kërkojë që të shtohet një pikë e rendit të punës sepse automjeti transportues i cili i bartë të sëmurit nuk është adekuat për bartjen e pacientëve. Po që se transportohet me atë automjetin pacienti po vdiske për shkak se dritare nuk kishte , krevati ku ndodhet pacienti ishte pa kurrfarë amortizeri. Propozoj që në rend të punës të futet si pikë blerja e një automjeti për ndihmë të shpejtë me pajisje bashkohore për transportimin e të sëmurëve.

Kryesuesi thekson:- këtë çështje është më mirë ta diskutojmë te të ndryshmet sepse nuk kemi nevojë me shtuar si pikë të rendit të ditës por te të ndryshmet e diskutojmë.

Florim Shkreta thekson:-përgjigjet të cilat i keni dhënë sot po i shohë dhe kërkoj të dijë arsye se pse janë vonuar deri tash për shkak se dy muaj kam prit. Kërkesa është bërë në mënyrë të rregullt dhe nuk mendoj që e kam ofenduar dikend pse kam kërkuar përgjigje. Kërkoj të dijë se a është bërë në formë inati apo ku qëndron problemi për shkak se z. Mefail Suma ja keni dërguar përgjigjet kurse mu nuk mi keni dërguar.

Kryesuesi thekson:- në bazë të statutit të komunës dhe rregullores së punës së kuvendit të komunës ekzekutivi i komunës ka afat prej 60 ditëve me tu përgjigjur në pyetjet e parashtruara , që do të thotë se afat kanë pas edhe dhjetë ditë me të dhënë përgjigje por tu kanë dhënë përgjigjet kur janë bërë 50 ditë. Përgjigjet për z. Mefail Suma janë dërguar në afat 30 ditë dhe në mbrëmje kam vërejtur që nuk tu janë përgjigjur ekzekutivi në pyetjet të cilat i keni parashtruar dhe kam kërkuar sqarim nga ekzekutivi se pse nuk tu kanë përgjigjur dhe ekzekutivi i ka dhënë përgjigjet sot.

Florim Shkreta thekson:- e di që afati është 60 ditë , mirëpo atë ditë në seancë potencove që tash për tash mundemi me të dhënë përgjigje dhe pse duhet të pritet që në afat 60 ditë me i dhënë përgjigjet. Tash për tash nuk mundem me i lexuar dhe me dhënë ndonjë vërejtje. Mendoj që nuk është e ndershme dhe në këtë mënyrë nuk duhet me vepruar për shkak se nëse shkoni me inati e keni dalluar personin e gabuar që doni me qu inati dhe nuk është mirë. Për përgjigjet të cilat janë dhënë nuk do të diskutojë në këtë seancë por në seancën e radhës.

Kryesuesi thekson:- pyetjet të cilat kanë pas të bëjnë me kuvend aty për aty kam pas përgjigje. Tendencë nuk ka për shkak se një ditë më herët kam kërkuar nga ekzekutivi i komunës se pse nuk janë dërguar përgjigjet së bashku me përgjigjet të cilat ju kanë dhënë z.Mefail Suma dhe brenda një dite kanë bërë zgjidhje dhe në kopje fizike janë dërguar.

Florim Shkreta thekson:- nuk kam parashtruar pyetje të cilat kërkojnë kohë por kanë qenë pyetje që kanë mundur brenda afatit me u përgjigjur sepse unë kam dhënë betim si këshilltarë komunal dhe të gjitha çështje të cilat janë në interes të qytetarëve duhet me i parashtruar në kuvend. Nuk i kam parashtruar për me ngushtuar dikend pasi që si ekzekutiv keni defekte shumë dhe nuk kam pas qëllim për me ngushtuar dikend , mirëpo ju të shtini që me punuar me paramendime të këqija dhe kjo nuk më pëlqen dhe kërkoj që të jeni ma transparent për shkak se pyetjet të cilat parashtrohen në kuvend përgjigjet duhet të përcillen me material. Në qoftë se nuk keni mundësi me dhënë përgjigje nuk është asgjë por vetëm duhet të njoftoni me kohë.

Kryesuesi a ka edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim materialin shtesë, rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Miratimi i raportit financiarë për periudhën Janar-Mars 2018.**
3. **Informatë mbi ndarjen e bursave.**
4. **Informatë për raportin financiarë për periudhën Janar-Mars 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.**
5. **Informatë për raportin e performancës së komunës për vitin 2017.**
6. **Miratimi i listës së anëtarëve për tri komitetet konsultative.**
7. **Pyetje dhe përgjigje.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i raportit financiarë për periudhën Janar-Mars 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Shabi rexxhallari thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018 është në shumë prej 2,766,745.00 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-mars 2018 është në shumë prej 408,489.98 € apo 14.76 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 360,273.60 € apo 24.95 %, në mallra dhe shërbime 23,677.26 € apo 10.51 %, në shpenzime komunale 9,012.12€ apo 20.24 %, në subvencione dhe transfere 5,527.00 € apo 10.82 % dhe në shpenzime kapitale 10,000.00 € apo 1 %. Të hyrat vetanake për këtë periudhë tremujore 2018 janë realizuar në shumë prej 48,782.12 € apo për 15,293.42 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- lista e projekteve kapitale të shëndetësia që është potencuar blerja e veturave zyrtare. Kërkoj informacion se për çfarë vetura bëhet fjala dhe për çka do të shërbejnë.

Teuta Shkreta thekson:- ndriçimi të salla e sporteve të shkolla fillore ‘Ilaz Thaçi’ duhet të bëhet për shkak se ka edhe grupacione të rinjve në atë pjesë sepse është e terrueshme.

Sabedin Hasallari thekson:- shuma e shpenzimeve kapitale pse është më e vogël në tre mujorin e vitit 2018 në krahasim me tre mujorin e vitit 2017. Te pagesat të kategoria mallra dhe shërbime kemi një rritje dhe kërkoj të dijë arsyet.

Shabi rexxhallari thekson:- shpenzimet kapitale për këtë periudhë janë më të vogla sepse jemi në fazën procedurave të prokurimit të tenderëve. Në vitin 2017 kemi shpenzuar më tepër për shkak se kemi pas disa projekte dy vjeçare. Te mallrat dhe shërbimet shpenzimet janë më të mëdha dhe nuk do të thotë se i kemi kaluar kufijtë. Kur është miratuar buxheti janë paraparë që të blehen dy vetura njëra të qendra për punës sociale dhe njëra të shëndetësia dhe për momenti nuk e di si do të rrjedhin procedurat e më tutjeshme.

Rufki Suma thekson:- ne kemi planifikuar që në kuadër të drejtorive me blerë vetura për shkak se stafi i QKMF-së dhe QPS-së po ka takime të ndryshme dhe detyrohen që me vetura të komunës me udhëtuar. Qeveria nuk ka lejuar me blerë vetura dhe kërkon që veturat të merren me qira që si komunë e kemi kundërshtuar . Në momentin që kemi kundërshtuar ata kanë shprehur gatishmëri që procedurat e tenderimit me i kryer. Qëllimi ka qenë që me blerë veturë për kryerjen e shërbimeve administrative dhe ka mundur që të shfrytëzohet edhe për raste të ndryshme urgjente sepse ju jeni në dioni që shërbimi i dializës është duke u kryer me veturë të vogël për shkak të kushteve më të përshtatshme. Ndriçimi gati ka në tërë vendet për pos aty ku nuk ka pas shtylla por ajo varet prej propozimit nëse e sheh të arsyeshme shkolla për shkak se fusha e futbollit është planifikuar për nevoja të shkollës.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI FINACIARË PËR PERIUdhËN JANAR –MARS 2018

3. Informatë mbi ndarjen e bursave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- janë respektuar të gjitha procedurat. Gjithsejtë kanë aplikuar 46 studentë për bursë. Komisioni ka bërë verifikimin e dokumentacioneve dhe sipas rregullores e ka ranguar listën e aplikantëve për bursë. Para se me u publikuar lista i kam ftuar të gjithë studentët dhe e kemi prezantuar para tyre listën e studentëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për përfitimin e bursës. Ankesa nuk ka pasur dhe vërejtje ka pas në rregullore të çështja e poenave të fëmijëve të veteranëve, invalidëve të luftës , rasteve sociale. Unë ju premtova studentëve që do t'i nisim procedurat për plotësim ndryshimin e rregullores në kuvendin e komunës. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- komisioni ka kryer procedurat në bazë të rregullores dhe dy vitet e fundit që janë ndarë bursat ka qenë për lëvdatë. Nëse mendojmë që duhet të bëhet plotësim ndryshimi i rregullores mendoj që është në shpërputhje më atë se çka po e themi. Për vitin e ardhshëm mendoj që duhet të rritet numri i bursistëve.

Menduh Vlasi thekson:- unë do të propozoj por kuvendi duhet ta miraton për me shtuar numrin e studentëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- në KPF është diskutuar çështja e kriterëve për ndarjen e bursave sepse ka disa kriterë që mendoj se është mirë me i rishikuar dhe të merret parasysh poenat për fëmijët e veteranëve dhe nota mesatare për shkak se krijohet një shpërputhje me ata të cilët e kanë një notë mesatare shumë të mirë dhe ata të cilët e kanë notën mesatare shumë më të dobët . Duhet të jetë një pikë konsensuale që i barazon me studentët të cilët kanë notën mesatare më të lartë sepse është dikreminuese që dikush e ka notën mesatare nëntë dhe nuk mund me i arritur pikët me ata të cilin e ka notën mesatare shtatë për shkak të pikëve që i merr si fëmijë i veteranit apo me asistencë sociale. Sa i përket rritjes së numrit të bursistëve si grup parlamentarë në mbledhje të kuvendit patëm propozuar që me u rrit, mirëpo për arsye të ndryshme propozimi nuk u hedh në votim. Drejtorja për arsim dhe anëtarët e kuvendit duhen ta kenë parasysh që duhet të rritet numri i bursistëve.

Mefail Suma thekson:- dy herë u përmendë KPF-ja nga parafolësit që do të thotë paska pas mbledhje dhe pse nuk është njoftuar kuvendi.

Kryesuesi thekson:- çdo mbledhje e KPF-së i paraprinë mbledhjes së kuvendit të komunës.

Akif Shkreta thekson:- në mandatin e kaluar kemi parashtruar kërkesë që procesverbali i KPF-së me ju përcjellë edhe anëtarëve të kuvendit të komunës andaj kërkoj që kjo praktikë të përcillet edhe në këtë mandat në mënyrë që të dihet se çka është biseduar.

Kryesuesi thekson:- për mbledhjet e radhës sekretaria e kuvendit do ta përcjellë edhe procesverbalin e KPF-së.

Mefail Suma thekson:- radhitje e studentëve të cilët kanë aplikuar për përfitim të bursë është bërë mirë sepse janë ndarë në bazë të rregullores për ndarje të bursave.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

4. Informatë për raportin financiarë për periudhën Janar-Mars 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abil Thaçi (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL “Pastrimi”) thekson:- gjatë këtij tre mujori janë nënshkruar 59 kontrata familjare dhe një kontratë biznesore. Të hyrat e kompanisë janë në shumë prej 21 927,40 €. Shpenzimet për këtë tre mujorë janë në shumë prej 16842.00 €. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- ende nuk e kam kuptuar rolin dhe funksionin e kësaj kompanie. Kjo kompani a i përgjigjet kuvendit apo komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- në material është përcjellë një shifër prej 906 dhe sa prej tyre kanë të nënshkruara kontrata. A ka lokacione që nuk menaxhohen mbeturinat dhe cilat janë ato lokacione dhe arsyeja se pse nuk menaxhohen ato mbeturina.

Refet Kalisi thekson:- lokacione të cilat nuk barten mbeturinat është fshati Krvenik, lagja e Currve atje lartë dhe lagjja Bushi në Pustenik . Në të ardhmen do të mundohemi që edhe në ato pjesë me bërë bartjen e mbeturinave sepse kompania ka në plan që ta blen një kamion të vogël në mënyrë që me i bartur mbeturinat edhe në ato pjesë.

Sabedin Hasallari thekson:- ndërmarrja e ka potencuar që nga përmbauesi privat ka inkasuar 2075.00 € , kurse për shpenzime të përmbauesit privat ka shpenzuar 4190.00 € që do të thotë që humbje ka në shumë prej 2115.00 € më shumë se i kanë dërguar personat në përmbaues privat. Bordi i kompanisë është mirë që kur të merr vendime t’i analizon të gjitha rrethanat sepse shihet që kanë shkuar në humbje.

Abil Thaçi (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL “Pastrimi”) thekson:- kjo është shifra e ekonomive familjare të cilat i kanë nënshkruar kontratat. Sa i përket lokacioneve nuk e kam numrin e saktë por do të jap përgjigje në të ardhmen. Sa i përket çështjes së përmbauesit mjetet financiare i kthehen kompanisë dhe kontrata është për katër vite dhe kompania nuk humbë.

Florim Shkreta thekson:- obligimet të cilat i kemi ndaj kompanisë duhet të paguhen por nuk pajtohem me atë që jeni ngutë dhe nuk ju intereson interesi i qytetarëve. Është dashur që nëpërmes administratorëve të fshatrave me i njoftuar qytetarët . Në qoftë se do të njoftoheshin administratorët e fshatrave për këtë çështje komuna më lehtë do ta kishte sepse nuk do të akuzohet nga qytetarët për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- po të shikohet lista e personave të cilët janë dërguar në përmbaues privat është pak e tmerrshme sepse ka persona të cilët janë rast social të cilët kanë pas një shumë në vlerë prej 50 € apo më shumë dhe është dërguar në përmbaues dhe ka paguar dy apo trefishin e borxhit që e ka pas. Në KPF diskutuam për këtë çështje që me gjet një modul në mënyrë që mos me dëmtuar qytetarin dhe me ju dërguar vërejtjet çoftë gojarisht apo me shkrimë.

Nuriman Kuka thekson:- a ekziston ndonjë mundësi që me ju ndihmuar këtyre personave sepse po ndihem keq që po i shohë këta persona në listë

Akif Shkreta thekson:- janë ndëshkuar në përmbarues personat të cilët kanë nënshkruar kontrata me dashje të cilët ishin pro këtij projekti, ndërsa nuk janë ndëshkuar personat të cilët nuk kanë nënshkruar kontrata dhe mbeturinat ju barten edhe atyre që kanë nënshkruar kontratë dhe atyre të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë . Këtë çështje duhet ta diskutojmë në mënyrë që të zgjidhet problemi.

Mefail Suma thekson:- përgjigje nuk mu dha se e di që është shoqëri aksionare që është formuar nga komuna dhe kërkoj informacion se kuvendi a duhet të informohet apo ne t'i mbulojmë humbjet e këtyre në fund të vitit. A është pyetur komuna për çështjen e personave të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj kompanisë dhe a keni kërkuar forma tjera në mënyrë që qytetarët me i kryer obligimet të cilat i kanë ndaj kompanisë. Kjo çështje diskutohet te qytetarët dhe nëse është kompani me aksione qind për qind të komunës ne tua paguan borxhet atyre qytetarëve të cilët nuk kanë mundësi.

Abil Thaçi (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi") thekson:- kompania është me qind për qind me aksione të komunës dhe komisioni aksionarëve ka obligim që t'i raportojë kuvendit të komunës. Për çdo tre muaj jemi të detyruar që t'i japim informatë komunës për mbarëvajtjet e punës sepse jemi të obliguar me Ligj. Komuna nuk është pyetur për çështjen pagesave dhe kemi kërkuar nga administrata që qytetarët kur të kërkojnë dokumentacion për regjistrim të automjetit me ju kërkuar edhe vërtetimin për kryerjen e obligimeve ndaj kompanisë. Hapësira në ligj nuk ka që ne me i kushtëzuar qytetarët për këtë çështje. Me bordin e drejtorëve dhe komunën do t'i diskutojmë të gjitha çështjet.

Rufki Suma thekson:- iniciimi i themelimit të kompanisë ka qenë nga kuvendi i komunës dhe me vendim të qeverisë është themeluar kompania me qind për qind aksione të komunës. Ligji e përcakton që kompania me raportuar çdo tre muaj për çështjet financiare dhe në fund të vitit raport vjetorë. Komisioni i aksionarëve është ndërlidhës në mes të kuvendit dhe kompanisë . Kompania e ka kryeshefin ekzekutiv , e ka bordin që merr vendime për kompaninë. Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave është miratuar në kuvendi e komunës. Kompania është themeluar qe një kohë të shkurtë dhe askush nuk e ka ditur se përmbaruesi për pesë euro t'i merr pesëmbëdhjetë euro që do të thotë që përmbaruesi përfiton nga kjo dhe kompania të vetmen formë e ka pas që përmes përmbaruesit. Komuna e ka vërejtur se nuk është mirë të shkohet me përmbarues sepse përmbaruesi vetëm mjetet financiare që i kanë borxh qytetarët ja kthen kompanisë . Rastin e kemi me tatimin në pronë që qytetarëve ju kemi dërguar vërejtje me shkrim me të cilën i kemi njoftuar për obligimet ndaj komunës. Është diskutuar çështja e personave të cilët janë me raste sociale por ka rast që personat që marrin ndihmë sociale i kanë kushtet më të mira se sa disa familje që nuk e kanë asnjë të hyrë nga shteti. Në të ardhmen nëse komuna e vlerëson që i kemi pesëdhjetë raste të cilët janë me varfëri ekstreme kuvendi mund të merr vendim që me i liruar nga taksa.

Besarat Suma thekson:- ata të cilët nuk po paguajnë mbeturinat dhe kur vijnë me mbushë ujë në fshatin Dimcë po i hedhin mbeturinat që do të thotë ajo pjesë nuk po pastrohet.

Mefail Suma thekson:- a ekziston mundësia që ata të cilët e bëjnë bartjen e mbeturinave me pas fletëpagesën me vete në mënyrë që qytetarët me i kryer obligimet ndaj kompanisë sepse personalisht unë nuk e kam ditur se ku është zyra e kompanisë për pagesën e mbeturinave.

Florim Shkreta thekson:- kamerat janë të vendosura nëpër Han të Elezit dhe mund të identifikohen personat të cilët i hedhin mbeturinat në kontinier të madh dhe të cilët nuk paguajnë mbeturina , mirëpo nuk janë interesuar personat përgjegjës në këtë drejtim. U potencua që nuk i kanë ditur pasojat e përmbaruesit dhe mendoj që nuk është arsye e mirë sepse shumica janë juristë. Është mirë që tjera herë mos me bërë hapa të ngutshëm apo ndoshta isha unë fajtori që kam qëlluar në listë dhe për shkak timin ndoshta janë dërguar në përmbarues.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte 14 për 1 kundër (prezent ishin 15 këshilltarë të asamblesë komunale).

U MIRATUA RAPORTI FINACIARË PËR PERIUdhËN JANAR MARS 2018 TË

5. Informatë për raportin e performancës së komunës për vitin 2017.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Fari Kalisi thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

6. Miratimi i listës së anëtarëve për tri komitetet konsultative.

Kryesuesi thekson:- kuvendi ka marr vendim për panelin intervistues për përzgjedhjen e komiteve konsultative. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e komiteve konsultative e kemi diskutuar para dy mbledhjeve dhe kemi marr vendim për panelin intervistues. Për anëtarë të panelit kemi dalë disa herë në konsultime me shefat e grupeve parlamentare dhe kemi arritur një marrëveshje. Përzgjedhja që është bërë nga paneli shihet se komisioni nuk ju ka përmbajtur marrëveshjes që kemi bërë për përzgjedhjen e anëtarëve në komitete konsultative. Kërkoj që të rishqyrtohet puna e panelit intervistues dhe kjo listë të analizohet edhe një herë dhe të kthehet në pikën zero.

Kryesuesi thekson:- pjesë e diskutimeve kur është formuar paneli kam qenë edhe unë dhe marrëveshje me shkrim nuk ka pas , mirëpo tërheqja e kandidatit të PDK-së ka qenë që unë po tërhiqem por në përzgjedhjen e kandidatëve nga paneli të shikohet mundësia e përfshirjes edhe të kandidatëve të PDK-së në komitete konsultative. Sa janë kandidatët e përfshirë në këto komitete konsultative mund të deklarohen anëtarët e komisionit.

Isni Bushi thekson:- konkursi ka qenë për tri komitete konsultative por fillimisht nuk është plotësuar numri i kandidatëve në dy komitete konsultative dhe është vazhduar konkursi edhe për një javë në mënyrë që të aplikojnë numri i mjaftueshëm në ato komitete. Pas përfundimit të konkursit janë ftuar kandidatët në intervistë dhe si komision jemi munduar në mënyrë më të mundshme me i përzgjedhur personat të cilët janë më profesionistë nëpër komitete përkatëse edhe pse ka pas raste që një kandidat ka konkurruar në dy apo tri komitete. Në panel intervistues nuk ka pas vetëm prej kuvendit por edhe prej shoqërisë civile dhe secili anëtarë ka bërë notimin sipas mendimit të vetë dhe kemi ardhur deri te një përfundim që mendoj që është mënyra më e mundshme e përzgjedhjes që na kemi menduar.

Teuta Shkreta thekson:- na jemi shumë të kënaqur sepse kemi bërë punën ashtu siç duhet dhe besojmë që janë të përfshirë të gjithë. Përzgjedhja është bërë në bazë të kriterëve dhe si komision jemi munduar që të del një rezultat shumë u mirë.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë nuk i kontestova emrat e personave se a janë kredibil apo nuk janë kredibil dhe nëse më keni kuptuar drejtë dhe qartë ishte diçka tjetër prej asaj te emrat se sa e kanë merituar apo nuk e kanë merituar. Me të thanë të drejtë unë shohë persona të cilët kanë të kryer fakultetin dhe janë jashtë listave dhe ka prej tyre që nuk kanë të kryer fakultet dhe janë brenda në listë dhe nuk dua ta diskutojë këtë sepse është mendimi i panelit intervistues. Qëllimi është te marrëveshja sepse nuk ka shkuar mirë se si komision nuk di a ishte të njoftuar apo jo për shkak se nuk është në rregull me i ikur marrëveshjes. Çështjen e marrëveshjes e potencoj edhe kryesuesi i kuvendit se kishim një marrëveshje. Marrëveshjet duhet të realizohen sepse mund të dalin edhe pasoja të tjera dhe në mënyrë që mos me ardhur deri te ato kërkoj nga anëtarët e kuvendit që mos të miratohet lista e komiteve konsultative por të diskutojmë edhe një herë dhe të merremi veshë për një zgjidhje tjetër për përfaqësim. Unë nuk po kërkoj diçka jashtë marrëveshjes.

Isni Bushi thekson:- ne mendojmë që janë të përfaqësuara të gjitha partitë politike në bazë të mendimit tonë që i njohim personat.

Mehmet Ballazhi thekson:- si anëtarë i komisionit pasi mendoni se është përfaqësuar PDK-ja kush mendoni se është nga radhët e PDK-së. Unë jam kryetar i degës së PDK-së në Han të Elezit dhe njëherit shef i grupit parlamentarë i PDK-së në asamblenë komunale dhe si panel intervistues me këndë jeni konsultuar ju për këtë çështje pasi po mendoni që kemi përfaqësim. Në bazë të asaj marrëveshje si mendoni që ato persona që i keni zgjedhur e përfaqësojnë PDK-në.

Isni Bushi thekson:- unë nuk jam konsultuar me askënd dhe ne e dimë që z.Sulejman Vila e përfaqëson PDK-në dhe jemi bazuar që ka qenë person me përvojë. Emër nuk kam marr nga ju por ne e dinë që është anëtarë i PDK-së.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne e dimë ngjarjen se si ka ndodhur por unë po kërkoj diçka në bazë të marrëveshjes dhe nuk mundesh me potencuar në mënyrë hipotetike se e përfaqëson një parti politike. Në kuadër të PDK-së unë jam me grupin parlamentarë se kush e përfaqëson PDK-në dhe me hipoteza nuk mundemi me shkuar me bërë përzgjedhje.

Rufki Suma thekson:- komitete oblikative ligji i obligonë që me pas përfaqësim të subjekteve politike. Komitete konsultative janë organe të kuvendit të komunës dhe janë apolitike dhe ndryshe është ajo që keni pas ndoshta marrëveshje që të përfaqësohet por për asnjë person nuk guxon me deklaruar se ka ardhur prej ndonjë subjekti politik për shkak se janë apolitike dhe ka mundur të jeni krejt të një partie politike apo dy partie politike. Paneli ka pas përbërje politike prej kuvendit , ekzekutivit të komunës, shoqërisë civile, kurse kandidatët nuk mund të shkojnë në kuadër të partive politike.

Mehmet Ballazhi thekson:- si kryetar i komunës a jeni në dioni që kemi pas një marrëveshje politike me grupet parlamentare.

Rufki Suma thekson:- nuk jam i njoftuar sepse keni dal dhe keni diskutuar për panelin.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne kemi dal për konsulta dhe kemi bërë një marrëveshje politike për këtë rast dhe unë kërkoj që ajo marrëveshje të zbatohet. Si grup parlamentarë vendosim për dikëndë që mendojmë që e përfaqëson qytetarin në komitetet konsultative. Unë e shohë një panelistë këtu që mund të jetë konflikt interesit që mendoj që është familjarizëm.

Kryesuesi thekson:-ata të cilët kanë konflikt interesi nuk kanë votuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- kjo çështje shihet qartë por edhe një herë po kërkoj shumë njerëzisht sepse kjo nuk është ligj kushtetues por është ligj morali sepse kemi bërë një marrëveshje të tillë. Kërkoj që të jeni pakë më konsekuentë në këto marrëveshje në mënyrë që të mësohemi me i respektuar për shkak se të gjithë jemi qytetarë të komunës së Hanit të Elezit dhe nuk kemi probleme të tjera. Marrëveshja duhet të respektohet sepse jemi në fillim të mandatit dhe me një herë keni filluar mos me i respektuar marrëveshjet. Edhe një herë kërkoj nga anëtarët e kuvendit që sot mos të miratohet por të rishikohet edhe një herë.

Kryesuesi thekson:- sa për sqarim secili e dinë pozicionin e vetë . Në këtë marrëveshje i kam anëtarët e kuvendit dhe e di që nuk mundem me më thënë asnjëri që kam pas preferenca. Unë mendoj se nëse z.Mehmet Ballazhi pasi paska pas marrëveshje është dashur që me diskutuar më herët me panelistat për marrëveshjen sepse unë nuk ju kam ndërhy që keni marrëveshje me këtë parti apo me atë parti. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte 11 për 3 kundër. (prezent ishin 14 këshilltarë të asamblesë komunale).

U MRIATUA LISTA E ANËTARËVE PËR TRI KOMITETE KONSULTATIVE

7. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Akif Shkreta thekson:- propozoj që të pastrohet qyteti për çdo ditë për shkak të ndotjes nga pluhuri. Për çështjen azbestit e dimë që ka qenë një projekt qeveritarë dhe nga komuna janë dhënë disa vërejtje mediatike por mendoj që ka përfunduar ai projekt. Është problem çështja e azbestit sepse nëpër shtëpitë tona ka ende dhe sa ka kapacitet komuna jonë me bërë një projekt të tillë që me i evidentuar mbetjet e azbestit që me i larguar. Kërkoj që për vitet e ardhshme me rishqyrtuar çështjen e maturantëve që po shkojnë në eskurzionë në Shqipëri apo së paku me bërë shëtitje një ditore nëpër Kosovë.

Florim Shkreta thekson:- pse Hani i Elezit është bërë vendi më i ndotur në Kosovë, a pse e ka kryetarin më të mirë në Kosovë edhe kjo duhet me ju shtuar apo për çfarë arsye .

Mefail Suma thekson:- para se me hedh në votim e propozova që të futet si pikë e rendit të punës dhe insistoje që të blehet një autoambulancë për transportimin e pacientëve dhe nëse nuk besoni bane një inskenim dhe do ta shikoni se si do të mbërrini deri në Ferizaj. Të sëmurit të cilët nisen me u transportuar nga Hani i Elezit sëmurën edhe 30 % më tepër gjatë transportimit. Këtë çështje duhet ta merrni parasysht për shkak se jemi në shërbim të qytetarëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- pse nuk transmetohen mbledhjet e kuvendit drejtë për drejtë qoftë përmes televizionit lokal “Elektra” apo një mundësi tjetër me u bërë transmetimi një dit apo dy pasi të mbahet mbledhja e kuvendit. Sqarimet që i kishit dhënë në përgjigje për mundësitë që nuk janë dhe me këtë çështje kanë problem edhe komunat tjera por neve na intereson komuna jonë dhe e dimë që ka kosto buxhetore, mirëpo duhet të xhindet mundësia për shkak se nuk është ndonjë shumë e pa përballueshme. Është mirë të bisedoni me kompaninë “Elektra” për transmetimin direkt të seancave në mënyrë që qytetarët të shohin debatet dhe vërejtjet që neve mund të na japin në mënyrë që me përmirësuar mënyrën e diskutimit dhe të punës së kuvendit këtu. Mbledhjet duhet të transmetohen drejtë për drejtë ose me ritransmetim sepse këtë ligji e lejon.

Rufki Suma thekson:- QKMF-ja i ka tri autoambulanca dhe njërën prej tyre e ka të re që e ka blerë para tri apo katër viteve Ministria e Shëndetësisë , kurse dy tjera kanë qenë të përdorura. Mund të ketë defekte te klima apo te nxehja qendrore por ato defekte riparohen. Gjatë transportimit ke mundur me qëlluar me ata e cila është më e dobët për shkak se njëra gati është e pa përdorshme kurse tjetra është e re por ka pas ndeshje në komunikacion dhe është riparuar por mund të ketë kohë pas kohe dëme që riparohen. Nuk e kemi para të arsyeshme me blerë tjera sepse duhet të riparohen ata të cilat janë. Për bartje të dializës ja kemi ofruar automjetin e vogël të komunës sepse është më mirë për pacientët. Ne kemi paraparë që me blerë një veturë të vogël për nevojat e administratës së QKMF-së dhe e cili mund të përdoret edhe për ndonjë rast që është i nevojshëm. Ambulanca par tri apo katër viteve ka qenë zero zero që e ka dërguar Ministria e Shëndetësisë , ndërsa tjerat kanë qenë të përdorua. Si pikë të rendit të punës nuk mundemi me shtijë por në momentin që bëhen planifikimet buxhetore mund të planifikojmë për me blerë një autoambulancë. Rregulloja për ndarjen e bursave do të hynë në plotësim ndryshim që studentët të cilët janë me notë mesatare të lartë me ju mundësuar marrja e bursës. Kur të behet planifikimi i buxhetit duhet të shikohen mundësitë buxhetore për me rrit shumën e mjeteve financiar për ndarje të bursave. U potencua që Hani i Elezit është më i ndoturi në Kosovë por realisht nuk është, mirëpo për shkak punimeve të cilat është t’i bërë autostrada mund të jetë më i ndotur se ka qenë më përpara. Vizita e nxënësve në Shqipëri ka pas raste që kanë dashur me ndërprerë në komunën e Malishevës por nxënësit kanë protestuar dhe i lejuan . Kjo çështje vendoset përmes drejtorisë dhe këshillit të prindërve. Për transmetimin e mbledhjeve kemi biseduar edhe vitet e më hershme dhe nëse nuk e bëjmë në këtë drejtim duhet që përmes rrjetit social fesbuk me i transmetuar. Ministria na ka mbajtur peng dy vite duke potencuar se do të transmetohen përmes sistemit në mënyrë direkte me u transmetuar në opinion por deri më tani konkrete diçka nuk ka. Kompania “Elektra” zyrtarisht nuk ka drejtë me lidhë kontratë për shkak se është rrjet kabllorë.

Mefail Suma thekson:-përgjigjet të cilat janë dhënë janë të një anshme ashtu siç ju ka pëlqyer juve. Mu nuk më intereson se çka thotë MAPL-ja se sa përqind e ka realizuar transparencën në komunë por më intereson se unë çka shohë. Unë nuk i di dhe ka edhe shumë njerëz që si dinë ato kanalet për me hyrë në fesbuk. Mos mendoni se informimi i qytetarëve është i mjaftueshëm për punën e kuvendit dhe ju po i bëni qef vetës sepse nuk është ashtu siç mendoni. Duhet të gjendet forma që të njoftohet qytetari dhe komuna duhet ta shpërndanë te qytetarët përmes fesbukut. Keni pas një far ahengu për ditëlindjen e kryetarit të komunës dhe në titull keni shënuar se kolektivi i komunës ndaloj për momentet për të bërë ndarjen e momentit të urimit dhe shkak kuptohet këtu a ndaloj frymëmarrjen, a ndaloj punën , a ndaloj vallen. Duhet ta dini se leksiku i gjuhës shqipe ka shumë fjalë për me i përdorur sepse brenda dy fjalëve ke përdorur dy herë momentin. Autoambulanca nuk i plotëson kushtet për transportimin e një të sëmuri sepse po të ishte e mirë nuk do ta dhuroni si donacion. Ju sugjeroi që dikush të shtrihet dhe të shkon deri në Ferizaj. Drejtorja e shëndetësisë duhet t'i shikon këto çështje sepse ju jeni profesional se cilat çështje janë më prioritet për me i blerë.

Mehmet Ballazhi thekson:-për çështje të transparencës është mirë që të bisedohet me foto Dernjanin i cili gjatë manifestimeve po e bënë një punë shumë të mirë. Ekzekutivi i komunës duhet të bisedon me të dhe incizimet të cilat do t'i bënë ne të transmetohen përmes rrjeteve sociale.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit në pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 13:01.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

